

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: BARAZI GJINORE

Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Target: 5.3

5.3 Të eliminohen të gjitha praktikatat e dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat në moshë të hershme dhe martesat e detyruar dhe gjymtimi gjenital femëror.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

14 (1)

1. Shtetet palë marrin parasysh problemet e veçanta që u shtrohen grave fshatare dhe rolin e rëndësishëm që luajnë këto gra për mbijetesën ekonomike të familjeve të tyre, duke përfshirë punën e tyre në sektorin jomonetar të ekonomisë. Ato marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në dobi të grave të zonave bujqësore.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

Neni 16.2.

16.2. Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë efekt juridik, prandaj merren të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistr zyrtar.

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor
Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor

Neni 5

Në përputhje me detyrimet themelore të përcaktuara në nenin 2 të kësaj Konvente, Shtetet Palë marrin përsipër të ndalojnë dhe eliminojnë diskriminimin racor në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit, pa dallim sa i përket racës, ngjyrës, ose kombëtar ose etnik. origjina, për barazinë para ligjit, veçanërisht në gëzimin e të drejtave të mëposhtme:

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Konventa ndërkombëtare
mbi eliminimin e të gjitha
formave të diskriminimit
racor

Konventa ndërkombëtare
mbi eliminimin e të gjitha
formave të diskriminimit
racor

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

Nenet

Neni 5. b.

5. b. E drejta e sigurisë së personit dhe e mbrojtjes së tij nga shteti kundër dhunës dhe keqtrajtimit qoftë nga funksionarët qeveritarë, qoftë nga ndonjë grup ose institucion i veçantë?

Neni 7

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe as dënimeve ose trajtimit me mizori, çnjerëzore e poshtëruese. Një veçanti, askush nuk duhet t'i nënshtrohet një eksperimenti mjekësor ose shkencor pa pëlqimin e tij të lirë.

Neni 25

Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

Neni 25a

(a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;

Neni 25b

(b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;

Neni 3

Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimit me çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 3

Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

Neni 16.1

1. Burrat dhe gratë në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi.

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

Neni 5

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtërues.

Neni 25 para 1

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

1. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Neni 19

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 24.3

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

24.3 Shtetet Palë do të ndërmarrin të gjitha masat efektive dhe të përshtatshme me qëllim shfuqizimin e praktikave tradicionale paragjyqëse për shëndetin e fëmijëve.

Ligjet **Nenet**

Nuk ka rezultat